

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, “Çështja Maçi kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 21051/10), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 8.8.2024, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 40 e vendimit ishte:

40. Gjykata vëren më tej se Shteti i paditur ka një detyrim të papërbushur **për të zbatuar vendimin e vitit 2006, të ndryshuar nga vendimi i vitit 2008**. Në të njëjtën kohë, Gjykata thekson se i takon më së shumti Shtetit të paditur që të zgjedhë mjetet që do të përdoren në rendin e tij juridik të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, sipas nenit 46 të Konventës (shihni *Shofman kundër Rasisë*, nr. 74826/01, § 53, 24 nëntor 2005, me referenca të mëtejshme). Në këtë çështje, nëse një autoritet vendas i pavarur konfirmon pa mëdyshje se zbatimi i vendimeve përfundimtare të brendshme është i pamundur (për shembull, për shkak të interesave të detyrueshme dhe legjitime publike ose private), i takon Shtetit të paditur që të zbatojë me shpejtësi masat e duhura për të korrigjuar situatën individuale të kërkuësve (shihni, *mutatis mutandis*, *Tarverdiyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 33343/03, § 66, 26 korrik 2007).

Bëhet:

40. Gjykata vëren më tej se Shteti i paditur ka një detyrim të papërbushur **për të zbatuar vendimet gjyqësore që mbeten të ekzekutueshme**. Në të njëjtën kohë, Gjykata thekson se i takon më së shumti Shtetit të paditur që të zgjedhë mjetet që do të përdoren në rendin e tij juridik të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, sipas nenit 46 të Konventës (shihni *Shofman kundër Rasisë*, nr. 74826/01, § 53, 24 nëntor 2005, me referenca të mëtejshme). Në këtë çështje, nëse një autoritet vendas i pavarur konfirmon pa mëdyshje se zbatimi i vendimeve përfundimtare të brendshme është i pamundur (për shembull, për shkak të interesave të detyrueshme dhe legjitime publike ose private), i takon Shtetit të paditur që të zbatojë me shpejtësi masat e duhura për të korrigjuar situatën individuale të kërkuësve (shihni, *mutatis mutandis*, *Tarverdiyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 33343/03, § 66, 26 korrik 2007).